



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:919479
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05559602

C.nr. 1271/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve J.Sh. dhe Q.B. të përfaqësuar me autorizim nga L.D.P. dhe S.M. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës K. SH.A. me seli në P., Bulevardi “B.K.”, Nr..., e përfaqësuar me autorizim nga A.D., lidhur me çështjen kontestimore nga marrëdhënia e punës anulim i vendimit dhe kompensim i pagave, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor në prani të autorizuarës së paditësve dhe të autorizuarës së të paditurës, ndërsa përpiloj me datë 04.04.2024, këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve J.Sh. dhe Q.B..

II. ANULOHET Vendimi Nr. 6649 i datës 13.08.2015 dhe Vendimi Nr. 5880 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit J.Sh. i datës 21.07.2015 i të paditurës K. SH.A. me seli në P. si i pa bazuar në ligj.

III. DETYROHET e paditura K. SH.A. me seli në P., që në emër të ardhurave personale brenda periudhës së kontratës së punës nga data 23.01.2015 e deri më datë 07.05.2016, të paguaj:

- a) Paditësit J.Sh. në emër të pagave neto t’ia paguaj shumën prej 4,297.20 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 250.00 euro, në emër të tatimit në pagë shumën prej 452.80 euro dhe në emër të kamatës për periudhën nga data 23.01.2015 e deri në nxjerrjen e ekspertizës me datë 28.08.2023 shumën prej 2,637.64 euro.
- b) Paditësit Q.B. në emër të pagave neto t’ia paguaj shumën prej 4,617.82 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 268.75 euro, në emër të tatimit në pagë shumën prej 488.43 euro dhe në emër të kamatës për periudhën nga data 23.01.2015 e deri në nxjerrjen e ekspertizës me datë 28.08.2023 shumën prej 2,828.18 euro.

IV. DETYROHET e paditura K. SH.A. me seli në P. që shumat e gjykuara si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi për borxhin kryesor në emër të pagave neto, t’i paguaj me kamatë ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbaramit ligjor.

V. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit J.Sh. me të cilën ka kërkuar kthimin në vendin e punës dhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 41,348.56 euro dhe paditësit Q.B. me të cilën kanë kërkuar kthimin në vendin e punës dhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 57,650.57 euro.

VI. DETYROHET e paditura që paditësve të ju kompensoj shpenzimet procedurale në lartësinë prej 2,895.60 euro, në afat prej shtatë (7) ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor, ndërsa pjesa tjetër e kërkuar në emër të shpenzimeve procedurale në shumën prej 3488.86 euro refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paraqitja e padisë dhe pretendimet e palëve

Paditësit J.Sh., E.T. dhe Q.B., në këtë gjykatë me datë 10.10.2015 kanë paraqitur padi duke kërkuar të detyrohet e paditura K. SH.A. me seli në P., që t'i kthej në vendin e punës dhe t'i sistematizoj në vendet e punës të cilat i kishin para se të merrej vendimi për shkëputjen e kontratave të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, po ashtu, të detyrohet e paditura që për kohën prej shkëputjes së kontratës e deri në ditën e kthimit në punë të u'a kompenzon të ardhurat personale me kamatë ligjore, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Paditësit përmes padisë kanë theksuar se me të paditurën ishin në raport punëmarrës – punëdhënës, me kontratë në kohë të pacaktuar. Paditësit ishin të sistemuar në Departamentin për humbje të energjisë elektrike (DTL) Distrikti i P.. Me vendimin e të paditurës Nr. 555/3 i datës 23.01.2015, paditësit janë larguar përkohësisht nga puna duke u suspenduar. Kanë shtuar se, arsyeja e suspendimit ka qenë fillimi i procedurës penale dhe arrestimi i paditësve me dyshim se kanë kryer veprë penale të marrjes së ryshfetit. E paditura me vendimin Nr. 5880 i datës 21.07.2015 në mënyrë të njëanshme i'u ka shkëputur kontratën e punës duke i larguar nga puna paditësit. Më tutje, kanë theksuar se ankesat e tyre të ushtruara kundër vendimit të shkallës së parë, me vendimin Nr. 6649 i datës 13.08.2015 Drejtori Ekzekutiv i Divizionit të Rrjetit i ka refuzuar dhe vendimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin C.nr. 2106/15 i datës 25.04.2019 kishte aprovuar pjesërisht të bazuar padinë e paditësve, ndërsa, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin A.C.nr. 96/2020 i datës 21.03.2022, këtë aktgjykimin në raport me paditësin E.T. e kishte vërtetuar, ndërsa, për paditësit J. Sh. dhe Q.B. lëndën e kishte kthyer në rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas sugjerimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit, ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor dhe shqyrtimit kryesor dhe ka administruar provat sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse.

E autorizuar e paditësve në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesim në tërësi pran padisë së dorëzuar në gjykatë, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën të aprovoj, me kërkesë që paditësit t'i kthej në vendin e punës si dhe të ju kompensoj pagat, tatimin, e të gjitha me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës. Më tutje, ka shtuar se duke marr parasysh se në këtë çështje kontestimore jemi në procedim të serishëm, për çka Gjykata e Apelit me Aktgjykim Ac. nr. 96/20 me të drejt dhe në mënyrë profesionale ka gjetur shkeljet e gjykatës së shkallës së parë, duke prishur aktgjykimin C.nr.2106/15 dhe duke aprovuar ankesën e paraqitur në emër të paditësve si të themeltë, dhe kjo për faktin se me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësve për kthim në vendim e punës ka bërë shkelje ligjore, ashtu siç është cekur me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ku e paditura ka dështuar të dorëzoj prova materiale për pretendimet e paraqitura gjatë shqyrtimit të mëparshëm se kinse paditësit kanë bërë shkelje të rënda të punës. Njëkohësisht, ka theksuar se paditësit janë larguar në mënyrë të pa drejtë nga puna, me pretendimet se të njëjtit kanë kryer veprën penale marrje e ryshfetit, mirëpo lidhur me këtë pretendim paditësit janë shpall të pafajshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.348/15. Po ashtu, në seancën e shqyrtimit kryesor, e autorizuar e paditësve e ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar që të: Detyrohet e paditura që paditësin J. Sh. të kthej në vendin e punës duke e anuluar si të pa ligjshëm vendimin e datës 21.07.2015, i cili është vërtetuar me vendimin me nr. 6649 datë 13.08.2015, si dhe në bazë të plotësimit të ekspertizës në emër të të ardhurave personale për periudhën 23.01.2015 deri me dt.31.01.2020 t'i paguaj pagat neto në vlerë prej 23,587.78 euro, në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumë prej 1,378.12 euro, në emër të kontributit pensional të punëmarrësit shumë prej 1,378.12 euro, të gjitha këto të llogaritur me kamatë prej 15,004.54 euro. Ndërsa, për paditësin Q.B. të kthej në vendin e punës duke e anuluar si të pa ligjshëm vendimin e datës 21.07.2015, i cili është vërtetuar me vendimin me nr. 6650 i datës 13.08.2015, si dhe në bazë të plotësimit të ekspertizës në emër të ardhurave personale për periudhën 23.01.2015 deri me dt.31.12.2023 t'i paguaj pagat neto në vlerë prej 41,451.75 euro, në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumë prej 2,474.90 euro, në emër të kontributit pensional të punëmarrësit shumë prej 2,474.90 euro, të gjitha këto të llogaritura me kamatë prej 11,249.02 euro, sipas plotësimit të dytë të ekspertizës të datës 31.01.2024. Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse largimi i paditësve nga puna është bazuar në tërësi në elementet e veprës penale, për të cilën veprë penale paditësit janë shpallur të pafajshëm përmes aktgjykimit penal të kësaj gjykate, dhe si rrjedhojë nuk ekziston ndonjë shkelje disiplinore e kryer nga paditësit. Ka shtuar se e paditura nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit të Punës me rastin e largimit të paditësve nga marrëdhënia e punës, dhe bazuar në këtë nga gjykata ka kërkuar që të shqyrtoj të gjitha provat veç e veç, të aprovoj padinë e paditësve, të anuloh vendimin me të cilin janë larguar nga puna, t'i kthej paditësit në vendet e tyre të punës dhe të detyroj të paditurën të paguaj shpërblimin e dëmit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë sipas kërkesës lidhur me vlerën e kontestit në total për dy paditësit në shumë prej 103,313.85 euro, duke u bazuar në Tarifat e OAK-së, siç janë: për përpilimin e padisë shumë në vlerë prej 406.23 euro, për tri seanca gjyqësore në shqyrtimin e parë shumë prej 528.50 euro për secilën seancë, për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimit C.nr.2106.15 të datës 25.04.2019 shumë në vlerë prej 406.23 euro, për 6 seanca në shqyrtimin e dytë edhe atë e datës 03.04.2023 shumë prej 528,50 + 30% i seancës për orën e dyte shumen prej 158.50 euro, për seancën e datës 26.05.2023 shumë prej 528.50 euro + 30% i seancës për

orën e dytë shumë prej 158.50 euro, për seancën e datës 23.08.2023 e cila zgjat dy orë shumë në vlerë prej 528.50 euro + 30% i seancës për orën e dytë shumë prej 158.50 euro, për seancën e datës 11.01.2024 shumë prej 528,50 euro, për seancën e datës 12.02.2024 shumë prej 528,50 + 30% i seancës për orën e dytë shumë prej 158.50 euro si dhe për seancën e datës 14.11.2024 shumë prej 528,50 + 30% i seancës për orën e dytë shumë prej 158.50 euro gjithsej për padi dhe seanca shuma totale e shpenzimeve të procedurës kontestimore 6,232.46 euro. Po ashtu, i ka kërkuar edhe shpenzimet për taksën e padisë sipas aktvendimit të gjykatës, për nxjerrjen Ekspertizës Financiare të Ekspertit A.B. shumë në vlerë prej 152.00 euro, për plotësimin e Ekspertizës Financiare të Ekspertit F.K. shumë prej 152.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

E autorizuar e të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndron në tërësi pran përgjigjes në padi dhe të gjitha deklarimeve nga seancat e kaluara, duke e kundërshtuar kërkesën e paditësve për faktin se ndaj të njëjtëve është zhvilluar procedura disiplinore si rezultat i shkeljeve të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me Kodin Disiplinor të Kompanisë, si dhe të Ligjit të Punës, dhe atë neni 70, paragraf 1.6, me të cilin pa periudhë paralajmëruese punëdhënësi mund të shkëpus kontratën e punës të punësuarit i cili është fajtor për përsëritje të një keq sjellje ose për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave dhe detyrimeve të punës. Në këtë rast paditësit kanë bërë shkelje të detyrimeve përkatëse siç është lejimi i vazhdimit të keqpërdorimit të energjisë elektrike nga konsumatori, e në këtë rast i ka sjellë dëm të paditurës, e në kuptim të nenit 85 paragraf 1 të Ligjit të Punës janë paraparë masat disiplinore siç është edhe ndërprerja e marrëdhënies së punës. Ka shtuar se, Gjykata e Apelit gjatë vlerësimit të saj ka konstatuar se nuk është marr ndonjë masë tjetër disiplinore paraprake, mirëpo e njoftojmë gjykatën se si masë paraprake ndaj të njëjtëve ka qenë suspendimi për periudhën prej 6 muajve, kur paditësit kanë marr 50% të pagës. Po ashtu, ka theksuar se vendimet e marra nga ana e saj janë të ligjshme dhe se është konstatuar drejt ana faktike si dhe është zbatuar drejt e drejta materiale. Më tutje, ka theksuar se arsyeja e ndarjes së përgjegjësisë disiplinore nga ajo penale për paditësit është bërë për arsye se të njëjtit kanë bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës përveç marrjes se ryshfetit kanë lejuar edhe furnizimin me energji elektrike në mënyrë të pa autorizuar konsumatorin në vazhdimësi e cila përbën shkelje të kodit dhe politikave të kompanisë si dhe procedurat e aprovuar nga ZRrE, andaj edhe shkëputja e kontratës së punës vjen pikërisht për këto dy arsye, dhe natyra e përgjegjësisë penale dallon nga ajo disiplinore për shkak të drejtave dhe përgjegjësisë që kanë të punësuarit ndaj punëdhënësit. Ndërsa, në fjalën përfundimtare ka ritheksuar se pretendimi i paditësve se të njëjtit janë liruar nga përgjegjësia penale duhet nënkuptuar se të njëjtit lirohen edhe nga përgjegjësia disiplinore për shkeljen e rëndë të detyrave të punës, është i pa bazuar për faktin se përgjegjësia disiplinore dhe përgjegjësia penale janë të ndara njëra nga tjetra. Ka shtuar se vendimi për largim nga puna është marr në përputhje me dispozitat e Ligjit të punës duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, mirëpo të njëjtat nuk i ka specifikuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit

kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Vendimi me Nr. 5580 i datës 21.07.2015 për ndërprerje të marrëdhënies së punës për paditësin J.Sh., Vendimi me Nr. 6649 i datës 13.08.2015 për refuzimin e ankesës së paditësit J.Sh., Vendimi me Nr. 555/3 i datës 23.01.2015 për suspendimin e paditësve nga marrëdhënia e punës, kontrata e punës për paditësin Q.B. e datës 01.09.2014, kontrata e punës për paditësin J.Sh. e datës 01.09.2014, ekspertiza financiare e datës 31.10.2018, kontratat e punës për paditësin J.Sh. të datës 04.01.2012, 04.04.2012, 01.01.2013, 08.05.2013, 01.01.2014, 01.09.2014, Vendimi për vazhdimin e suspendimit të paditësve me Nr. 2147 i datës 18.03.2015, propozimi i paraqitur nga paditësi J.Sh. ndaj të paditurës për rishqyrtim të vendimit për shkëputjes të kontratës, kërkesa për rikthim në punë në emër të paditësve, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Penal me Nr. PKR.348/15, dhe i Gjykatës së Apelit me Nr. PAK .nr.226/17, ekspertiza financiare e datës 14.07.2023 dhe plotësimet e saj të datës 28.08.2023 së bashku me plotësimin e saj të dorëzuar në seancën e datës 11.01.2014, si dhe plotësimet e datave 31.01.2024 dhe 13.02.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tani e tutje LPK), e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në vijim, gjykata do të trajtojë dhe do të jap vlerësim për secilën pikë të kërkesëpadisë së paditësve veç e veç, duke theksuar edhe faktet vendimtare që kanë qenë të rëndësishme në lidhje me një vendosje të tillë.

Gjykata në lidhshmëri me faktet e paraqitura e të administruara në shqyrtimin kryesor, vlerëson së në këtë çështje juridike kontestimore duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili përcakton të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Gjendja faktike dhe baza ligjore për paditësin J. Sh.

Nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura dhe marrëdhënia e punës ka qenë e themeluar përmes kontratave të punës. Tutje, nuk ishte kontestuese se ky raport juridik i punës është krijuar që nga data 04.01.2012. Nuk ishte kontestuese se raporti juridik i paditësit dhe të paditurës, kishte ndryshuar në ndërkohë, me lidhjen e kontratave të reja të punës të palëve ndërgjyqëse, kontrata këto të administruara gjatë procesit gjyqësor, e që janë pjesë edhe e shkresave të lëndës. Me këto kontrata, raporti juridik i punës mes paditësit dhe të paditurës, ishte ndryshuar me vullnetin e të dyja palëve ndërgjyqëse, ndryshim ky që i referohej pozitës së punës së paditësit, dhe kohëzgjatjes së kontratës së punës.

Më tutje, nuk ishte kontestuese se paditësi është suspenduar me pagesë në lartësi të 50% të pagës së tij nga marrëdhënia e punës, në kohëzgjatje prej gjashtë muaj me Vendimin Nr.555-3 e datës 21.01.2015. Po ashtu, nuk ishte kontestuese në mes të palëve se paditësit i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me Vendimin Nr.5880 i datës 21.07.2015, me pretendimin se paditësi së bashku me kolegët e tij me datë 17.11.2014 me rastin e inspektimit të Hotel T. në P. kishin vërejtur se është duke u vjedhur rryma elektrike dhe përkundër këtij konstatimi, të njëjtit nuk e kanë evidentuar në procesverbal me ç‘rast mbikëqyrësit të këtij Hoteli në këmbim të mos shkyçjes së energjisë elektrike i kanë kërkuar shumën prej 1000 euro, të cilën shumë sipas këtij Vendimi paditësi e ka marr dhe pastaj ka përpiluar procesverbal me konstatimin se gjendja e

rrymës është në rregull. Si rrjedhojë, e paditura e kishte larguar nga puna paditësin nga data 21.07.2015 mbi bazën e keq sjelljes.

Nuk ishte kontestuese se paditësi ka paraqitur ankesë në Komisionin e Ankesave të e paditura, kundër Vendimit Nr.5880 i datës 21.07.2015, me të cilin i është ndërprerë marrëdhënia e punës, i cili Komision me Vendimin Nr.6649 i datës 13.08.2015 e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar.

Njëkohësisht, nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, se paditësi përmes aktgjykimit penal, i nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe i vërtetuar nga Gjykata e Apelit, është liruar nga përgjegjësia penale.

Mirëpo, kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte ligjshmëria e Vendimit Nr.5880 i datës 21.07.2015, i vërtetuar me Vendimin Nr. 6649 i datës 13.08.2015, me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, dhe mbi këtë bazë paditësi kërkon që kërkesëpadia e tij të aprovohet edhe për kërkesat e tjera.

Fillimisht, gjykata e trajtoj dhe analizoj Vendimin Nr. 5880 i datës 21.07.2015, përmes të cilit Vendim, paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, dhe nga analizimi i këtij vendimi në raport me dispozitat e Ligjit të Punës, gjykata konstatoj se ky vendim është i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet të anulohet. Bazuar në këtë vendim, dhe në deklaratimet e të paditurës në seanca të shqyrtimit gjyqësor, e po ashtu edhe në përgjigje në padi, gjykata konstatoj se i vetmi pretendim i të paditurës mbi bazën e të cilit paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, është pretendimi se me datën 17.11.2014, paditësi *“në këmbim të mos shkyçjes së energjisë elektrike nga konsumatori ka marr shumë prej 1000 euro”*. Lidhur me këtë pretendim të paditurës, ishte iniciuar procedura penale, për çka paditësi ishte akuzuar për veprën penale marrje e rryshfetit, mirëpo, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.348/15 i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.226/17, paditësi ishte liruar nga kjo akuzë, për çka gjykata kishte marr aktgjykim lirues.

Në lidhshmëri me të lartcekurat, në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit, Ligji N.nr. 03/L-212 i Punës në nenin 70 paragraf 4 se bashku me nën-paragrafët 4.1. dhe 4.2. parasheh se: *“1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në: 1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe 1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.”* ndërsa, në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë se e paditura e ka zbatuar këtë detyrim.

Kurse, më tutje, me nenin 70 paragraf 1 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 të Ligjit të Punës N.nr. 03/L-212 në mënyrë shprehimore përcaktohet se: *“Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit për periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur: 1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.”*, ndërsa, sa i përket zbatimit të pikës së lartë theksuar 1.61. në paragrafin 2 të nenit 70 të Ligjit të Punës përcaktohet se: *“Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë*

të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuari ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuari duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim”, po ashtu, edhe në paragrafin 3 të këtij neni parashihet se: “Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t’ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t’ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuari ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet.”

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme, për faktin se asnjëherë nuk është konstatuar se paditësi i ka kryer veprimet për të cilat e paditura i ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Meqenëse, në rastin konkret, pretendimet e të paditurës ngërthenin në vete elemente penale, e të cilat në procedurë penale nuk janë vërtetuar, e të cilat po ashtu ishin të vetmet pretendime të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, atëherë gjykata vlerëson se në këtë rast nuk mund të ekzistoj as përgjegjësia disiplinore, si bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ndërsa, në të njëjtën kohë, e paditura nuk i ka ndërmarr veprimet ashtu siç përcaktohet me nenin 70 të Ligjit të Punës, të cekura si më lartë, me çka rezulton se e paditura përmes Vendimit Nr.5880 i datës 21.07.2015, i vërtetuar me Vendimin Nr. 6649 i datës 13.08.2015 në mënyrë të kundërligjshme i ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit, për çka gjykata vendosi që të njëjtat vendime të anulohen sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pasi që gjykata konstatoj sikurse me lartë, se vendimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës kanë qenë të kundërligjshme, vendosi që paditësit t’ia njeh të drejtën në pagat e pa realizuara brenda periudhës së kontratës së punës, dhe atë nga data 23.01.2015 e deri më datë 07.05.2016. Bazuar në këtë, gjykata e detyroj të paditurën që paditësit t’ia paguaj në emër të pagave neto shumë prej 4,297.20 euro, në emër të kontributit pensional shumë prej 250.00 euro, në emër të tatimit në pagë shumë prej 452.80 euro dhe në emër të kamatës së akumuluar për periudhën nga data 23.01.2015 e deri në nxjerrjen e ekspertizës me datë 28.08.2023 shumë prej 2,637.64 euro.

Në raport me lartësinë e këtyre shumave të aprovuara sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata vendosi duke u bazuar në plotësim ekspertizën e ekspertit gjyqësor financiar të datës 28.08.2023, e cila përmban vetëm pjesën e kalkulimit brenda periudhës së kontratës, duke zbritur periudhën e pagesës gjatë kohës së suspendimit prej 50 % për gjashtë muaj. Eksperti financiar, në seancën e shqyrtimit kryesor i ka dhënë sqarimet e nevojshme në raport me këtë ekspertizë. Gjukata konstatoj se kjo ekspertizë është hartuar në mënyrë profesionale, në përputhje me detyrat e caktuara paraprakisht, e njëjta përmban kalkulimin e pagave neto të paditësit sipas kontratës, e duke i përfshirë edhe obligimet nga trusti pensional dhe tatimin në pagë.

Gjendja faktike dhe baza ligjore për paditësin Q. B.

Nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura dhe marrëdhënia e punës ka qenë e themeluar përmes kontratës së punës. Po ashtu, nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë i punësuar në pozitën e punës Kontrollimi i Humbjeve në Terën në Departamentin për Humbje të Energjisë Elektrike.

Më tutje, nuk ishte kontestuese se paditësi është suspenduar me pagesë nga marrëdhënia e punës në kohëzgjatje prej gjashtë muaj me vendimin e datës 21.01.2015, e po ashtu nuk ishte kontestuese në mes të palëve se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Njëkohësisht, nuk ishte kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, se paditësi përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.348/15 i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.226/17, është liruar nga përgjegjësia penale.

Mirëpo, kontestuese në mes të paditësit dhe të paditurës ishte ndërprerja e kontratës së punës, për çka paditësi pretendon se kontrata i është ndërprerë në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës.

Fillimisht, gjykata vlerëson se në shkresa të lëndës nuk gjendet ndonjë vendim përmes të cilit paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, po ashtu, nuk gjendet ndonjë ankesë e paraqitur nga paditësi në raport me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në shkresa të lëndës gjendet vetëm Vendimi Nr.555-3 i datës 21.01.2015, përmes të cilit paditësi është suspenduar nga marrëdhënia e punës.

Në lidhshmëri me këtë, Ligji i Punës në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 72 parasheh: *“1. Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje. 2. Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit.”* Sipas kësaj dispozite, është obligim i punëdhënësit me rastin ndërprerjes së kontratës të nxjerr vendim me shkrim se bashku me pjesën e arsyetimit, dhe njëkohësisht, është detyrim i punëdhënësit që këtë vendim t'i dorëzoj të punësuarit. Bazuar në këtë, e paditura në cilësi të punëdhënësit nuk ka përmbushur këtë detyrim, dhe rrjedhimisht nuk ka nxjerr vendim për ndërprerjen e kontratës së punës.

Meqenëse, afati për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas nenit 79 të Ligjit të Punës është afat prekluziv, dhe i njëjti duhet të vlerësohet nga gjykata qysh në shqyrtimin paraprak të padisë, lidhur me këtë vlerësim, gjykata në mungesë të vendimit për largim nga puna, e në bazë të shkresave të lëndës, për të konstatuar afatshmërinë e padisë, vlerësoj aspektin e momentit se kur paditësi ka kuptuar, apo është njoftuar se i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Lidhur me këtë, e paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se: *“ka udhëhequr procedurën disiplinore me datë 05.06.2015 ndaj paditësve dhe mbi bazën e administrimit të provave ka konstatuar shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe ka nxjerr vendime për shkëputje të marrëdhënies së punës me nr. të protokollit 5877, 5878, 5880 të datës 21.07.2015.”* Po ashtu,

më tutje e paditura në përgjigje në padi ka shtuar se: *“edhe përkundër faktit se paditësit kanë ushtruar ankesë kundër vendimit të shkallës së parë në instancë të dytë në kuadër të paditurës K., kjo e fundit e refuzon me arsyetim se me asnjë provë nuk mund të shfaqësohen nga shkeljet e rënda të detyrave të punës të përcaktuar me aktin e brendshëm të paditurës Kodin Disiplinore.”*

Bazuar në deklaratimet e lartcekura të paditurës, e duke e analizuar Vendimin e datës 21.07.2015 me Nr.5880 me të cilin paditësit J.Sh. i është ndërprerë marrëdhënia e punës, e po ashtu, pasi që e paditura i referohet edhe vendimeve për shkëputje të marrëdhënies së punës për paditësit Q.B. dhe E.T. me Nr. të protokollit 5877 dhe 5878 të datës 21.07.2015, e të cilat vendime, po ashtu sipas të paditurës janë apeluar në shkallën e dytë të e paditura, gjykata konstatoj se paditësi Q.B. i ka shfrytëzuar mjetet e brendshme të e paditura, e po ashtu padinë e ka paraqitur brenda afatit ligjor. Kjo edhe për faktin se, padia në gjykatë është paraqitur me datë 10.09.2015, kurse, vendimi i shkallës së parë është nxjerr me datë 21.07.2015, ndërsa, vendimi i shkallës së dytë me datë 13.08.2015 (referuar vendimit për paditësin J.Sh.) dhe rrjedhimisht del se padia është paraqitur brenda ligjor ashtu siç përcaktohet me nenin 79 të Ligjit të Punës.

Për me shumë, e duke u bazuar edhe në vlerësimin si me lartë, dhe nga analizimi i shkresave të lëndës, gjykata konstatoj se paditësi Q.B. padinë në gjykatë e ka paraqitur se bashku me paditësin J.Sh. dhe E.T.. Siç është theksuar me lartë, në raport me paditësin E.T., gjykata e shkallës së parë e kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e tij, duke konstatuar se marrëdhënia e punës i është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme, duke e detyruar të paditurën të kompensoj pagat dhe të kthej në vendin e punës, i cili aktgjykim i shkallës së parë ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Ndërsa, lidhur me këtë, nga shkresat e lëndës dhe të gjitha provat dhe deklaratimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, rezulton se për paditësin Q.B. dhe E.T., i vetmi vendim në raport me largimin nga puna, është vendimi për suspendim nga puna. Kurse, njëjtë sikurse paditësit Q.B., po ashtu, edhe E.T. nuk i është lëshuar ndonjë vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e po ashtu në shkresa të lëndës, nuk figuron nëse i njëjti ka konsumuar mjetet juridike të brendshme të punëdhënësi.

Mbi këtë bazë, duke marr për bazë faktin se ish paditësit E.T. në këtë procedurë, kjo gjykatë i kishte njohur të drejtën, duke e pranuar padinë si të afatshme, e njëkohësisht ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, në raport me këtë paditë, meqenëse kemi të bëjmë me të njëjtën procedurë, me të njëjtat prova, dhe me të njëjtat rrethana në raport me ndjekjen e procedurës së brendshme të punëdhënësi, vlerësoj se padia e paditësit Q.B. duhet të trajtohet si e afatshme. Në këtë përfundim, gjykata arriti duke marr parasysh edhe parimin e trajtimit të barabartë të palëve, dhe atë ashtu siç përcaktohet me nenin 31 paragraf 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh: *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”* Bazuar në këtë, gjykata vlerësoj se paditësit Q.B. duhet t'i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave të tij në këtë procedurë.

Bazuar në pretendimet e palëve ndërgjyqëse, dhe atë sikurse në padi, në përgjigje në padi dhe në seancat e shqyrtimit kryesor, gjykata vlerëson se i vetmi shkak mbi bazën e të cilit paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës është se kinse me datën 17.11.2014, paditësi *“në këmbim*

të mos shkyçjes së energjisë elektrike nga konsumatori ka marr shumën prej 1000 euro”. Lidhur me këtë pretendim të paditurës, ishte iniciuar procedura penale, për çka paditësi ishte akuzuar për veprën penale marrje e ryshfetit, mirëpo, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.348/15 i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.226/17, paditësi ishte liruar nga kjo akuzë, për çka gjykata kishte marr aktgjykim liruës.

Në lidhshmëri me të lartcekurat, në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit, Ligji N.nr. 03/L-212 i Punës në nenin 70 paragraf 4 se bashku me nën-paragrafët 4.1. dhe 4.2. parasheh se: *“1.4. punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në: 1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe 1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.”* ndërsa, në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë se e paditura e ka zbatuar këtë detyrim.

Kurse, më tutje, me nenin 70 paragraf 1 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 të Ligjit të Punës N.nr. 03/L-212 në mënyrë shprehimore përcaktohet se: *“Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit për periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur: 1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.”*, ndërsa, sa i përket zbatimit të pikës së lart theksuar 1.6.1. në paragrafin 2 të nenit 70 të Ligjit të Punës përcaktohet se: *“Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-paragrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejme me shkrim”,* po ashtu, edhe në paragrafin 3 të këtij neni parashihet se: *“Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t’ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t’ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuarit ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet.”*

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paditësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme, për faktin se asnjëherë nuk është konstatuar se paditësi i ka kryer veprimet për të cilat e paditura i ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Meqenëse, në rastin konkret, pretendimet e të paditurës ngërthenin në vete elemente penale, e të cilat në procedurë penale nuk janë vërtetuar, e të cilat po ashtu ishin të vetmet pretendime të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, atëherë gjykata vlerëson se në këtë rast nuk mund të ekzistoj as përgjegjësia disiplinore, si bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Ndërsa, në të njëjtën kohë, e paditura nuk i ka ndërmarr veprimet ashtu siç përcaktohet me nenin 70 dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 72 të Ligjit të Punës, të cekura si më lartë, me çka rezulton se e paditura në mënyrë të kundërligjshme i ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit.

Pasi që gjykata konstatoj sikurse me lartë, se ndërprerja e marrëdhënies së punës ka qenë e kundërligjshme, vendosi që paditësit të i’a njeh të drejtën në pagat e pa realizuara brenda periudhës së kontratës së punës, dhe atë nga data 23.01.2015 e deri më datë 07.05.2016. Bazuar në këtë, gjykata e detyroj të paditurën që paditësit t’ia paguaj në emër të pagave neto t’ia paguaj

shumën prej 4,617.82 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 268.75 euro, në emër të tatimit në pagë shumën prej 488.43 euro dhe në emër të kamatës së akumuluar për periudhën nga data 23.01.2015 e deri në nxjerrjen e ekspertizës me datë 28.08.2023 shumën prej 2,828.18 euro.

Në raport me lartësinë e këtyre shumave të aprovuara sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata vendosi duke u bazuar në plotësim ekspertizën e ekspertit gjyqësor financiar të datës 28.08.2023, e cila përmban vetëm pjesën e kalkulimit brenda periudhës së kontratës, duke zbritur periudhën e pagesës gjatë kohës së suspendimit prej 50 % për gjashtë muaj. Eksperti financiar, në seancën e shqyrtimit kryesor i ka dhënë sqarimet e nevojshme në raport me këtë ekspertizë. Gjykata konstatoj se kjo ekspertizë është hartuar në mënyrë profesionale, në përputhje me detyrat e caktuara paraprakisht, e njëjta përmban kalkulimin e pagave neto të paditësit sipas kontratës, e duke i përfshirë edhe obligimet nga trusti pensional dhe tatimin në pagë.

Pjesa refuzuese e kërkesëpadisë së paditësve J. Sh. dhe Q.B.

Në raport me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësve, meqenëse kërkesat e refuzuara të paditësve ishin të njëjta dhe të njëjtat janë refuzuar mbi të njëjtën bazë, gjykata pjesën arsyetuese e trajtoj bashkërisht. Lidhur me kërkesën për kthimin e tyre në vendin e punës që e kishin paraprakisht tek e paditura, gjykata e refuzoi këtë pjesë të kërkesëpadisë së tyre, ngase në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të një marrëdhënie ekzistuese të punës, por kemi të bëjmë me mos vazhdim të saj, përkatësisht të kontratës.

Gjykata e refuzoi kërkesën e tillë të paditësve, pasi që kontrata e tyre e punës ishte me afat të caktuar, dhe atë nga data 23.01.2015 e deri më datë 07.05.2016, dhe e njëjta tashmë kishte skaduar. Bazuara në kontratat e punës së paditësve të lidhura me të paditurën, gjykata vlerëson se të njëjtit në cilësi të palëve kontraktuese janë pajtuar për elementet e kësaj kontrate, rrjedhimisht edhe për çështjen e afatit të saj, duke u dakorduar që kontrata mes tyre të jetë me afat të caktuar kohor. Në lidhshmëri me këtë, Ligji i Punës e parasheh ndërprerjen e kontratës së punës sipas fuqisë ligjore, dhe atë lidhur me rastin konkret në nenin 67 paragraf 1 nën-paragraf 1.3. përcakton se: *“Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës”*. Gjykata, bazuar në kontratat e paditësve e në lidhshmëri me këtë dispozitë vendosi që kërkesa e paditësve për kthim në vendin e punës të refuzohet si e pa bazuar.

Sa i përket kompensimit në emër të të ardhurave personale që i referohet periudhës për paditësin J.Sh. nga data 23.01.2015 deri me datë 31.01.2020, ndërsa për paditësin Q.B. nga data 23.01.2015 deri me datë 31.12.2023 (dita e hartimit të ekspertizës financiare), gjykata e refuzoi këtë pjesë për arsye se paditësit nuk kanë një bazë juridike nga e cila do të mund të realizonin kompensimin e tillë. Së këndejmi, pasi që kontrata e punës së paditësve ishte me afat të skaduar, dhe pasi që kthimi në vendin e tyre të punës që e ushtronin tek e paditura nuk mund të bëhet për arsyet e shpjeguara më lart, gjykata e refuzoi si të pabazuar kërkesën e paditësve për kompensim të ardhurave personale në këtë pikë.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, po ashtu, edhe provat e tjera duke përfshirë ekspertizën financiare se bashku me plotësimet e saj, të cilat janë administruar në shqyrtim kryesor, mirëpo, të njëjtat nuk ishin relevante dhe nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Për me shumë, e në lidhshmëri me pretendimet e lartcekura, e në përputhje me nenin 319 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.”* e po ashtu, në përputhje edhe me nenin 322 paragraf 2 të Ligjit të lartcekur, i cili njëkohësisht parasheh se: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provoj faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.”* gjykata konstatoj se paditësit kanë provuar në mënyrë të mjaftueshme të drejtën e tyre sikurse me lartë, andaj gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e tyre, kurse të njëjtit nuk kanë arritur të provojnë kërkesat e tjera nga padia, andaj, gjykata pjesën tjetër të kërkesëpadisë e refuzoi si të pabazuar. Më tutje, me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së, është paraparë se: *“në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”,* andaj gjykata kishte parasysh kërkesat e palëve me rastin e vendosjes.

Kamata ligjore

Sa i përket kamatës sikurse në pikën III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata e aprovoj propozimin e paditësve, ashtu që në emër të kamatës se akumuluar për periudhën nga data 23.01.2015 e deri në nxjerrjen e ekspertizës me datë 28.08.2023, e obligoj të paditurën që të paguaj shumat sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se kamata lidhur me kërkesat nga pagat dhe kërkesat e tjera materiale nga marrëdhënia e punës sikurse në rastin konkret, fillon të rrjedhë nga arritja e secilës kërkesë veç e veç, pavarësisht nga dita se kur kërkohet mbrojtje gjyqësore ose kur behët vlerësimi i kërkesave të arritura. Në raport me lartësinë e kamatës për këtë periudhë, gjykata vendosi duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar gjyqësor, të cilën ekspertizë gjykata e vlerësoj si profesionale dhe të hartuar në përputhje me detyrat e dhëna. Ndërsa, për shumën e borxhit kryesor, përkatësisht pagave neto, gjykata e detyroj të paditurën t'i paguaj me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi. Lidhur me të lartcekurat, gjykata vendosi në përputhje me nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.”*

Shpenzimet e procedurës

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata vendosi sikurse në pikën VI të dispozitivit të aktgjykimit, dhe atë duke u bazuar në nenin 452, 453 dhe 463 të LPK-së dhe tarifën e Odës së Avokatëve. Lartësia e shpenzimeve i referohet hartimit të ankesës në shumën prej 312.00 euro, përfaqësimit të paditësve në 6 seanca gjyqësore, secila në shumë prej 405.60 euro, apo 2,433.60 euro, në emër të ekspertizës financiare shumën prej 150.00 euro, e në total shumën prej 2,895.60 euro. Ndërsa, pjesën tjetër të shpenzimeve në shumën prej 3488.86 euro, gjykata e refuzoj si të

pa bazuar, për faktin se sa i përket kërkesës për këto shpenzime të krijuara gjatë shqyrtimit të parë, pasi analizoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe aktgjykimin e shkallës së dytë lidhur me këtë çështje, nga të njëjtit konstatoj se këto shpenzime janë njohur përmes aktgjykimit të shkallës së parë, ndërsa, në raport me këtë, pasi që nuk kishte pretendime ankimore, të njëjtat janë vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, që nënkupton se të njëjtat janë njohur apo gjykuar me aktgjykimin paraprak.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr. 1271/2022, datë 04.04.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të së njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.